

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal,** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi në lëndën penale kundër të akuzuarit F. H nga fshati Zh. K. Gj me mbrojtësit e tij me autorizim av. G. A. nga Gj për shkak të veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gj., Departamenti i Përgjithshëm PP II.nr. 2014/2015, të datës ...., të cilin e përfaqëson prokurorja K. F, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, mbi pranimin e marrëveshjes së fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit, të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij, më datën 18.10.2016, mori dhe në prezencë të palëve shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri F. H., nga i ati R., e ëma Xh., e lindur B. , i lindur më dt... në fsh. Zh.r , ku dhe jeton, ka të kryer shkollën mesme , i martuar-baba i pesë fëmive, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike ,shqiptar, shtetas i R.Kosovës,më parë i pa dënuar dhe nuk udhëheqet procedurë për vepër tjetër penale.

### **Është fajtor**

Sepse më dt.... rreth or;s ... minuta, në fshatin Zh K. Gj, i pandehuri F. H. ka penguar personat zyrtar të ..., A. M. dhe N. S. në kryerjen e detyrave zyrtare, në atë mënyrë që për deri sa të dëmtuarit sipas urdhëresës nga menagjeri i ..., kishin shkuar te shtëpia e konsumatorit dhe të njëjtin për shkak të mos pengimit të borxhit, e kishin çkyqë nga rrjeti elektrik duke ia vendosë bllobbën në njëhësor elektrik dhe pas çkyqjes dalin nga oborri i konsumatorit në atë moment me automjetin furgon në shtëpi të vet vie i pandehuri i cili pasi informohet se punëtorët e ... e kishin çkyqë nga rrjeti elektrik, i njëjti i pengon punëtorët e ... dhe me dashje me automjetin që e drejtonte e shtyen dhe e godet në dy këmbët të dëmtuarin A. M., i cili në momentin kritik ishte mbrapa automjetit zyrtar të .... duke i kërkuar në bagazh kambalecat për çkyqje dhe të njëjtit i shkakton lëndim të lehtë trupor, pastaj të njëjtëve iu drejtohet edhe me fjalë fyese duke i urdhëruar që të dalin nga oborri dhe rrugica ku të dëmtuarit e kishin ndalë automjeti zyrtar, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta ka penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare dhe njëkohësisht edhe të dëmtuarit A. M. i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor i cili për shkak të natyrës së lëndimit të pësuar detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore në Emergjencën e spitalit Regjional në Gj.me çka ka kryer veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s. Prandaj gjykata duke iu referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit Florim Hyseni, në bazë të neneve 4, 41, 42, 43, 50, 51,73 dhe 74 të KPRK-s, nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s.

### **E G J Y K O N**

Të akuzuarit F. H., i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 2 (dy) vite, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil. Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipsas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbaramit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Kundër të akuzuarit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore të përshkruara më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor dhe ka propozuar që pas mbajtjes së séances gjyqësore dhe shtjellimit të provave i akuzuari të shpallet fajtor dhe të denohet me denim meritor sipas ligjit.

Prokurorja e shtetit K. F. deklaron: në fillim bëjë përmirësimin e aktakuzës edhe atë sa i përket të dhënave personale ku në vend të datëlindjes .... duhet të jetë ....., Pas negociimit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, më dt....., kemi arritur marrëveshje, mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin F. H., ku i njëjti është pajtuar që të pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e atë gjithnjë në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësin e tij. Prandaj, bazuar në këtë kërkojmë nga gjykata që konform nenit 233 par.21 të KP që këtë marrëveshje dhe dënimin ta aprovojë.

Mbrojtësi i të pandehurit, sipas autorizimit av.G A. deklaron: me prokurorin e shtetit mbrojtësi av. G. A. ka negociuar marrëveshjen dhe janë pajtuar bashkarisht duke marrë pjesë edhe i pandehuri për të gjitha pikat të cilat janë të cekura në marrëveshje andaj gjykatës i propozoj që konform nenit 233 par.21 të KP që këtë marrëveshje dhe dënimin ta aprovojë.

I dëmtuari A. M. deklaron: pajtohem me marrëveshjen e arritur në mes të prokurorisë dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij dhe paraqesë kërkesë pasurore-juridike ndaj të pandehurit.

I pandehuri F. H., deklaron: e mbështes në tërësi deklaratën e mbrojtësit tim, dhe deklaroj se i kërkojë shumë falje të dëmtuarit A. dhe e pranojë gabimin që e kam bërë por këtë më së tepërmi e kam bërë për shkak të sëmundjes që vuaj.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke e njoftuar të akuzuarin me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK dhe e njëjta marrëveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vëhet në barrë dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë përjashtim si në nenin 248 të KPPRK.

Në seancën për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës i akuzuari dhe mbrojtësi i tij janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që të i shqiptohet denim me burg në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 2 (dy) vite, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Bazuar në nenin 453 të KPPRK-s, Gjykata e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në contest civil.

Përfaqësuesi i akuzës, i pandehuri dhe mbrojtësi i akuzuarit av. G. A. sipas autorizimit kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr. 08/2016 të datës 18.10.2016**

**Sek. Juridike,  
Igballe Azemi d.v**

**Gjykatësi i vetëm gjykues,  
Behar Ymeri d.v**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky aktgjykim është i plotëfuqishëm ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 233 par.12 pika 1, dhe pika 3.të KPPRK-ës.

Gjykatësi i vetëm gjykues komunikoi këtë,

## A k t v e n d i m

Aprovohet marveshja për pranimin e fajësisë e arritur më dt. 21.07.2016, në mes të prokurorit të shtetit, të akuzuarit F. H. dhe mbrojtëit të tij av.G. A.. Pasi që palët kanë arritur marveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionin penal në konform të nenit 248 par.4 të KPPK-, gjykatësi i vetëm gjykues merr,

### ***NË EMËR TË POPULLIT A K T G J Y K I M***

I pandehuri F. H., nga i ati R., e ëma Xh., e lindur B. , i lindur më dt.... në fsh. Zh , ku dhe jeton, ka të kryer shkollën mesme , i martuar-baba i pesë fëmive, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike ,shqiptar, shtetas i R.Kosovës,më parë i pa dënuar dhe nuk udhëheqet procedurë për vepër tjetër penale.

### **Është fajtor**

Sepse më dt.... rreth orës .... minuta, në fshatin Zh.. K. Gj, i pandehuri F. H. ka penguar personat zyrtar të ..., A. M. dhe N. S. në kryerjen e detyrave zyrtare, në atë mënyrë që për deri sa të dëmtuarit sipas urdhëresës nga menagjeri i ..., kishin shkuar te shtëpia e konsumatorit dhe të njëjtin për shkak të mos pengimit të borxhit, e kishin çkyqë nga rrjeti elektrik duke ia vendosë bllobën në njëhësor elektrik dhe pas çkyqjes dalin nga oborri i konsumatorit në atë moment me automjetin furgon në shtëpi të vet vie i pandehuri i cili pasi informohet se punëtorët e ... e kishin çkyqë nga rrjeti elektrik, i njëjti i pengon punëtorët e ... dhe me dashje me automjetin që e drejtonte e shtyen dhe e godet në dy këmbët të dëmtuarin A. M.u, i cili në momentin kritik ishte mbrapa automjetit zyrtar të ... duke i kërkuar në bagazh kambalecat për qkyqje dhe të njëjtit i shkakton lëndim të lehtë trupor, pastaj të njëjtëve iu drejtohet edhe me fjalë fyese duke i urdhëruar që të dalin nga oborri dhe rrugica ku të dëmtuarit e kishin ndalë automjeti zyrtar, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta ka penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare dhe njëkohësisht edhe të dëmtuarit A. M. i ka shkakuar lëndim të lehtë trupor i cili për shkak të natyrës së lëndimit të pësuar detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e spitalit Regjional në Gj. me çka ka kryer veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s. Prandaj gjykata duke iu referuar marveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit F. H., në bazë të neneve 4, 41, 42, 43, 50, 51,73 dhe 74 të KPRK-s, nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s.

### **E G J Y K O N**

Të akuzuarit F. H., i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 2 (dy) vite, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil. Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipsas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbaramit të dhunshëm. Përfundoi në ora 10.30 min.

V e r t e t o j n ë:

Sekretarja juridike

Gjykatësi i vetëm gjykues

